

**AKTI I THEMELIMIT**  
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Iv's Distilery Boutique Hotel” shpk**

Sot, në datë 07.09.2022, unë themeluesi, Ivi Xhelili, atësia Vesaf, shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I10228058B, i datëlindjes 28.02.1981, lindur në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1**  
**Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Iv's Distilery Boutique Hotel” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2**  
**Objekti**

- 4) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
  - a) Ofrimi i shërbimeve të akomodimit në struktura akomoduese, pushuese, turizmit, shërbimeve të biznesit, sallave të konferencave dhe shërbime e aktivitete të tjera të ngjashme në sektorin e Hoteleri/Shërbime.
  - b) Veprimtari në fushën Bar/Kafe dhe Restorant, ambienteve shplodhëse, aktivitete sportive, rekreative, pishina dhe veprimtari të tjera të ngjashme.
  - c) Importi dhe eksporti i materialeve dhe makinerive të tjera të ndryshme, pjesë e aktivitetit të shoqërisë.
- 5) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**


- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga “Raqi Qirinxhi”, numër pasurie 5/337, banesë private 14, Korçë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (Një qind) Lekë dhe është i ndarë në 1 (Një) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Ivi Xhelili.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet atësia Vesaf, shtetas Shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I10228058B, i datëlindjes 28.02.1981, lindur në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

\*\*\*

**ORTAK I VETËM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
“Ivi's Distilery Boutique Hotel shpk” shpk

Ivi Xhelili  
Ivi Xhelili  
(Emër, Mbiemër, Firma)